Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 11 - 01
Datë: 05.01.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit nr. 28/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 06.10.2025 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Riakreditohet dhe rivalidohet "Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës" (SHPDK), Rr. Murat Mehmeti BII- T5OB.1 KATI 2 NR.6, Prishtinë, për periudhën pesë (5) vjeçare (01.01.2026 deri 31.12.2030) me kualifikimin:

1. **"Instruktor në Vendin e Punës"**. Niveli i IV sipas KKK. Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 4 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri më 20 kandidatë për grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 5 grupe gjithsej 100 kandidatë brenda vitit.

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Bazuar në analizën e dosjes së aplikimit, gjetjet nga vizita vlerësuese, si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, dokumentacioni është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 22.12.2025.

Riakreditimi dhe rivalidimi bëhet bazuar edhe në arsyetimin e dhënë në raportin e ekspertëve në të cilin konstatohet se; Institucioni ka paraqitur të dhëna të qarta dhe të strukturuara për numrin e kandidatëve dhe grupet e planifikuara. Sipas dokumentacionit dhe deklarimeve të menaxhmentit gjatë vizitës, planifikohen 5 grupe trajnimi me 12–20 kandidatë secila, duke respektuar kufirin maksimal të lejuar për këtë kualifikim.

Institucioni mban dokumentacion të plotë për vijueshmërinë e kandidatëve, testet hyrëse, portofoliot, regjistrimin, monitorimin dhe rezultatet e vlerësimit.
Ekspertët vlerësuan se evidencat janë të mirëorganizuara dhe të arkivuara si në format fizik, ashtu edhe elektronik, duke siguruar gjurmueshmëri të plotë të progresit të kandidatëve.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni gjatë fazës së aplikimit, përfshirë: aplikacionet për validimin e kualifikimeve, aplikacionet për akreditimin e institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, si dhe gjetjet e evidentuara gjatë vizitës së realizuar tek pala aplikuese.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikime, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 për kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, është e obliguar të realizojë procesin e monitorimit dhe të raportojë tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

- Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, Prishtinë
- Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve